FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

TIMOLOL

Pika për sy, tretësirë – 0.5 %
(Timolol maleat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Timolol dhe përse përdoret?
2. Përpara se të përdorni Timolol
3. Si ta përdorni Timolol?
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Timolol?
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË TIMOLOL DHE PËRSE PËRDORET?
Timololi bën pjesë në grupin e beta – bllokuesve jopërzgjedhës. Pas pikimit të tretësirës në sy, timololi ul presionin normal dhe të rritur të syrit. Ulja e presionit intraokular ka lidhje me zvogëlimin e sintezës së lëngut ujor të syrit në trupin ciliar. Timololi, në ndryshim nga barnat miotike, nuk ndikon në përmasat e pupilës.
Timolol – pika për sy indikohet për uljen e presionit të rritur intraokular, në gjendje të ndryshme, si: në të sëmurët me hipertension të syrit, në të sëmurët me glaukomë kronike me kënd të hapur, përfshirë të sëmurët afakikë, në disa të sëmurë me glaukomë dytësore, indikohet edhe si mjekim shoqërues në glaukomën e fëmijëve që nuk mjekohet mirë nga barnat e tjera kundër glaukomës.

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI TIMOLOL
Mos përdorni Timolol nëse:
- jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj bllokuesve beta-adrenergjikë (siç është timololi) ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të barit pasi mund të shfaqen reaksione alergjie, përfshi dhe anafilaksinë;
- keni astmë bronkiale ose bronkospazëm ose keni patur në të kaluarën sëmundje obstruktive të rrugëve të frymëmarrjes;
- keni bronkopneumoni kronike obstruktive;
- keni bradikardi sinusale apo sindrom të sinusit të sëmurë;
- keni bllok atrioventrikular (A-V) të shkallës së dytë ose të tretë;
- keni dekompensim të theksuar të zemrës;
- keni shok kardiogjen;
- keni feokromocitomë (përveç rasteve kur përdoret me alfa – bllokues);
- keni hipotension;
- keni acidozë metabolike;
- keni anginë Prinzmetal;
- keni sëmundje të rënduar të arterieve periferike.

Tregoni kujdes të veçantë me Timolol
Pyesni mjekun tuaj përpara se të përdorni Timolol.
Këto pika duhen përdorur me kujdes në të sëmurët që përdorin edhe bllokues të tjerë beta – adrenergjikë ose kalcibllokues, sepse mund të shfaqen efekte sistemike.
Të sëmurët që marrin nga goja një bllokues beta – adrenergjik dhe që u përshkruhen edhe pika për sy timololi, duhen mbikqyrur për mundësinë e shfaqjes së një efekti aditiv, si në presionin e brendshëm të syrit, ashtu edhe në efektet e përgjithshme të kësaj kategorie barnash.
Kur pikat për sy të timololit përdoren për uljen e presionit të rritur intraokular, në glaukomën me kënd të ngushtë, është e nevojshme që të kombinohet me një bar miotik dhe të mos përdoren të vetme.
Nuk këshillohet përdorimi në shtatzëni. Në rastet e domosdoshme duhet të ballafaqohen përfitimet terapeutike për nënën me rreziqet e mundshme për fëmijën.
Nuk këshillohet përdorimi gjatë ushqimit me gji.
Në qoftë se është e nevojshme që të bëhet një kontroll më rigoroz i presionit intraokular, atëherë pikat për sy të timololit mund të kombinohen me miotikë, adrenalinë dhe frenues të anhidrazës karbonike (jo për përdorim lokal, por sistemik).
Pikat për sy të timololit mund të maskojnë simptomat e hipertiroidizmit dhe hipoglicemisë.
Pikat për sy të timololit duhen përdorur me kujdes në bllok atrioventrikular (A-V) të shkallës së parë, miasteni gravis dhe psoriazë.
Timolol duhet përdorur me kujdes në pacientët që vuajnë nga sëmundje korneale.
Lentet e buta të kontaktit duhen hequr para përdorimit të Timolol pika për sy (shih "Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Timolol").
Përdorimi i barit mund të japë rezultate pozitive në testet antidoping.
Fëmijët
Përdorimi në fëmijë kërkon kujdes ekstrem dhe në çdo rast duhet të arsyetohet nga mjeku.

Marrja e barnave të tjera
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Timolol në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit. Ndërveprimet klinikisht të rëndësishme vërehen pas përthithjes sistemike të timololit.
Është **veçanërisht e rëndësishme** që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:
- anestezikë, anksiolitikë dhe hipnotikë;
- antihipertensivë (fuqizohet efekti hipotensiv);
- alfa-bllokues (fuqizohet efekti hipotensiv); gjithashtu, rrezik i shtuar për hipotension pas dozës së parë me alfa-bllokuesit postsinaptikë si prazosina;
- antiaritmikë (shtohet rreziku i deprimimit të miokardit, bradikardisë dhe bllokut atrioventrikuar);
- kalcibllokues dhe glikozide kardiake (shtohet rreziku i bradikardisë dhe i bllokut atrioventrikular);
- simpatomimetikë (mund të shfaqet hipertension i theksuar dhe bradikardi gjatë përdorimit me adrenalinë, noradrenalinë apo dobutaminë);
- alkaloidë ksantinikë (ulet efekti terapeutik);
- fingolimod (rrezik i mundshëm i shtuar për bradikardi);
- moksisilit (hipotension serioz postural i mundshëm).

Shtatzënia dhe Ushqimi me gji
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të përdorni këtë bar.
Siguria e përdorimit të këtij bari në shtatzëni dhe gjatë ushqimit me gji nuk është vërtetuar ende, prandaj duhet të evitohet përdorimi si gjatë shtatzënisë edhe gjatë ushqimit me gji (Kategoria C).
Në rastet e domosdoshme duhet të ballafaqohen përfitimet terapeutike për nënën me rreziqet e mundshme për fëmijën.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Timolol, duke qenë pika për sy (vendi i administrimit në sy), nuk duhet të përdoret në momentin e drejtimit të automjetit ose gjatë punës me makineri. Gjithashtu, duhet patur kujdes gjatë ditëve të kurimit sepse Timolol mund të japë efekte anësore të tilla si mjegullime dhe çrregullim të shikimit. Evitoni përdorimin e automjeteve dhe makinerive.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Timolol
Timolol – tretësirë me pika për sy 0.5% përmban klorur benzalkoni, i cili mund të shkaktojë irritim në sy. Shmangni kontaktin me lentet e buta të kontaktit. Hiqini lentet e kontaktit përpara aplikimit dhe prisni të paktën 15 minuta përpara se t'i rivendosni. Kloruri i benzalkonit njihet për çngjyrosjen e lenteve të buta të kontaktit.

3. SI TA PËRDORNI TIMOLOL?
Mjeku juaj do t'ju informojë për sasinë e timololit që duhet të përdorni dhe kur ta përdorni atë. Është e rëndësishme që të ndiqni udhëzimet e mjekut me përpikmëri dhe asnjëherë të mos e ndryshoni dozën vetë, sido që të ndiheni.
Pyesni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni të pasigurt për dozën që duhet të përdorni dhe kur duhet ta përdorni atë.

Dozimi:
1 pikë tretësirë, 2 herë në ditë në syrin e sëmurë.
Mënyra e administrimit të Timolol – tretësirë me pika për sy është:
- Lajini mirë duart
- Mos e prekni vendin e daljes së pikave
- Shikoni lart
- Ulni kapakun e poshtëm të syrit për të krijuar një ulluk
- Vendosni pikatoren sa më afër ullukut, por pa e prekur atë
- Hidhni sasinë e duhur të pikave në ulluk
- Mbyllni syrin për rreth 2 minuta
- Tretësira e tepërt që del mund të hiqet me një garzë sterile.

Pikat në sy mund të shkaktojnë ndonjë ndjesi djegieje, por kjo ndjenjë nuk zgjat më shumë se disa minuta. Në të kundërt konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Në qoftë se keni përdorur më shumë Timolol
Në qoftë se keni përdorur më shumë Timolol se sasia që duhet të përdornit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Rrallë ndodhin efekte anësore nga mbidozimi i timololit, pika për sy.
Megjithatë, efektet anësore që mund të ndodhin si pasojë e mbidozimit të timololit (këto doza të larta kalojnë në kanalin nazolakrimal) përfshijnë një përthithje sistemike të timololit që mund të shoqërohet me efekte beta-bllokuese sistemike si: konfuzion, pamjaftueshmëri të zemrës, vështirësi në frymëmarrje, bradikardi, hipotension, alopeci.

Në qoftë se harroni të përdorni Timolol
Në qoftë se harroni një dozë Timolol, përdoreni atë sa më shpejt. Në qoftë se është pothuajse koha për dozën tjetër, përdorni atë dhe kalojeni dozën e humbur. Mos përdorni dozë të dyfishtë Timolol për të plotësuar dozën e humbur.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Si të gjithë barnat e tjerë, Timolol mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet.
Pikat për sy të timololit në përgjithësi tolerohen mirë. Mund të ketë efekte anësore si dhimbje të syve, çrregullim të shikimit si dhe janë vërejtur raste të rralla të acarimit të lehtë të syrit.
Lënda vepruese (timololi) mund të përthithet në gjak, ashtu siç mund të ndodhë edhe me përgatesat e tjera oftalmike që përdoren lokalisht. Të njëjtat efekte të padëshirueshme që ndeshen gjatë përdorimit të bllokuesve beta – adrenergjikë me veprim të përgjithshëm mund të shfaqen edhe gjatë përdorimit lokal të tyre. Këto efekte janë:
- pamjaftueshmëri e zemrës, bradikardi, hipotension;
- bronkospazëm, dispne;
- dhimbje koke, marrje mendsh, çrregullime të gjumit (duke përfshirë makthet);
- lodhje, parestezi, ftohje e gjymtyrëve, përkeqësim i fenomenit Raynaud;
- rash, përkeqësim i psoriazës, alopeci (e rikthyeshme);
- trombocitopeni;
- hiperglicemi, hipoglicemi;
- çrregullime të traktit tretës.

Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se vëreni efekte të tjera jo të përmendura më lart.

5. SI TA RUANI TIMOLOL?
Ruajeni në një vend të thatë dhe të freskët në një temperaturë nën 25°C!
Duhet të ruhet nga drita.
Mos e ruani në ngrirje!
Mos e përdorni Timolol pas datës së skadencës!
Mbajeni barin në një vend të sigurt ku fëmijët nuk mund ta marrin! Ky bar mund t'i dëmtojë ata.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM
Çfarë përmban Timolol – pika për sy, tretësirë 0.5%
Lënda vepruese është timolol maleat.
1 ml tretësirë përmban 6.8 mg timolol maleat ekuivalent me 5 mg timolol (0.5%).
Përbërës të tjerë janë: klorur benzalkoni, dihidrogjenfosfat natriumi dihidrat, hidrogjenfosfat dinatriumi dihidrat, hidroksid natriumi (mund të shtohet për rregullim pH), ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 1 shishe plastike 5 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Pika për sy.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2016.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.